

**VENDIM
I ORTAKUT TË VETËM
TË**

SHOQËRISË “BIOCOSM” SHPK

Nr. 03, Datë 24. 02.2021

1. Sot më 24.02. 2021, unë, **ZnjNerta Tushe**, shtetase shqiptare, mbajtëse e letërnjoftimit nr. 034459127 dhe nr. personal I26026086D, në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë **“BIOCOSM” SHPK**, një shoqëri e krijuar dhe organizuar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS) M03820405A, (në vijim referuar si “Shoqëria”), me seli në adresën: Fier Lushnje, Lagjja Savër, Autostrada Lushnje Fier km 3, ndërtesa me nr.197, kati 1-rë, pranë karburant Kastrati, vendosi për rendin e dites si më poshtë:

RENDI I DITËS

1. Ndryshimin e objektit të veprimtarisë së Shoqërisë.
2. Miratimin e ndryshimit të Statutit të Shoqërisë.

Në lidhje me rendin e ditës së sipërpërmendur, Ortaku i Vetëm

V E N D O S I

1. Të miratojë ndryshimin e objektit të veprimtarisë i cili :

Ishte :

Prodhim i produkteve kozmetike bimore (Handmade). Import-eksport i produkteve kozmetike bimore dhe produkteve të tjera në shërbim të aktivitetit, regjim i përpunimit aktiv. Tregti të produkteve kozmetike

Behet :

“Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jete si vijon:

“BIOCOSM” SHPK

Prodhim i produkteve kozmetike bimore (te tilla si, krema, shampo, vajra, serume dhe jo vetem), te destinuara për t’u vendosur nëkontakt me pjesët e jashtme të trupit të njeriut (epidermë, flokë, thonj, buzë dhe organet e jashtme gjenitale) ose dhëmbë, membranat mukozë të kavitetit oral, me qëllim të vetëm ose kryesisht pastrimin e tyre, parfumosjen, ndryshimin e pamjes, mbrojtjen dhe mbajtjen e tyre në kushte të mira ose korrigjimin e erës së trupit.

Me qëllimin e realizimit te veprimtarise se saj, Shoqeria gjithashtu mund te kryeje veprime te cilat lidhen me shitblerjen me pakice dhe shumice te lendeve te para (ingradientet dhe substancat qe perdoren per krijimin e produkteve), paketimeve, etiketave, ambalazheve dhe kontenitoreve.

Ne pergjithesi, Shoqeria mund te kryeje te gjitha aktivitetet e dobishme ose te nevojshme te lejuara nga ligji, per realizimin e objektit te Shoqerise.”

2. Të miratojë ndryshimin e Statutit të Shoqërisë,

Të autorizojë Znj. Anisa Caushi, mbajtëse e letërnjoftimit nr. 033145064 dhe nr. personal 186210084L të veprojë në emër dhe për llogari të Shoqërisë, për të kryer çdo aplikim/procedurë ligjore të nevojshme dhe/ose për të nënshkruar çdo akt të nevojshëm dhe/ose të kërkuar, me qëllim depozitimin e këtij Vendimi si dhe Statutit të përditësuar pranë QKB-së për të pasqyruar ndryshimet e mësipërme në ekstraktin e Shoqërisë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ORTAKU I VËTËM

I

SHOQËRISË “BIOCOSM” SHPK

Nerta Tushe

